



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Oerd Bylykbashi – nënkryetar i komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 06 – 27 nëntor 2015.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, faza I ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KfW Frankfurt am Main, për fuqizimin institucional, për programin “Infrastruktura Bashkiake III/IV”, furnizimi me ujë dhe kanalizime për vendndodhjet Berat – Kuçovë, Delvinë, Gjirokastrë, Kamzë, Librazhd dhe Lushnjë”

Marrin pjesë:

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Fatmir Mediu, Silva Caka, Vasilika Hysi, Tom Doshi.

Të ftuar:

Ketrin Abazaj – specialiste në sektorin e Menaxhimit të Fondeve të Huaja në MTI

Jovan Gjika – specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve në MTI

Brikena Jazexhi - specialiste në Drejtorinë e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave

Oerd Bylykbashi – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Hapim mbledhjen e komisionit. E fillojmë pikërisht me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 06 – 27 nëntor 2015 dhe shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, faza I ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KfW Frankfurt am Main, për fuqizimin institucional, për programin “Infrastruktura Bashkiake III/IV”, furnizimi me ujë dhe kanalizime për vendndodhjet Berat – Kuçovë, Delvinë, Gjirokastrë, Kamzë, Librazhd dhe Lushnjë”. Relator është zoti Dashamir Peza. Ky është rendi i ditës. Kalojmë te kalendarin e punimeve të komisionit. Ka ndonjë sugjerim? Kush është dakord me kalendarin e punimeve të komisionit për periudhën 06 – 27 nëntor 2015? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, faza I ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KfW Frankfurt am Main, për fuqizimin institucional, për programin “Infrastruktura Bashkiake III/IV”, furnizimi me ujë dhe kanalizime për vendndodhjet Berat – Kuçovë, Delvinë, Gjirokastrë, Kamzë, Librazhd dhe Lushnjë”.

Sot nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të pranishme kemi zonjën Ketrin Abazaj, specialiste në sektorin e Menaxhimit të Fondeve të Huaja në këtë ministri.

Dhe zotin Jovan Gjika, specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

Fillimisht kërkoj një prezantim të shkurtër prej jush të kësaj marrëveshje që propozoni për të kaluar në parlament.

Jovan Gjika – Unë jam Jovan Gjika, koordinator i projektit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

Programet e Infrastrukturës bashkiake me investitor kryesor KfW-në, por dhe donatorë të tjerë, BE-ja dhe SEKO, kanë filluar në vitet 2009-2010 dhe sot kemi në zbatim fazën 1 dhe 2. Ndërsa sipas projektligjit, ka ardhur për diskutim faza 3 dhe 4 që përfshijnë këto qytete Berat, Kuçovë, Delvinë, Gjirokastrë, Kamzë, Librazhd dhe Lushnjë. Në kuadër të këtij financimi prej 600 mijë eurosh synohet të financohet

komponenti institucional që parashikon përzgjedhjen e një konsulenti ndërkombëtar institucional i cili do të mbështesë shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve në forcimin e kapaciteteve, hartimin ose abdejtimin e planeve të bizneseve, planeve të ndryshimit të tarifave, si dhe në procesin mjaft delikat, që është bashkimi i zonave rurale, ose sistemeve të fshatrave në kuadër të reformës së re administrative.

Ky financim është në vlerën e 600 mijë eurove dhe synon rritjen e kapaciteteve për stafet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në qytetet përfshira në këtë fazë të programit.

Oerd Bylykbashi - Faleminderit!

Po, zoti Peza.

Dashamir Peza – Unë besoj, se edhe nga relacioni është e qartë për të gjithë, që bëhet fjalë për një grant rreth 600 mijë euro i cili ka të bëjë me përzgjedhjen e konsulentit institucional për këto ndërmarrje të ujësjellës-kanalizimeve, të këtyre njësive administrative të reja, për t'i ndihmuar në çështjen e mbështetjes institucionale për të krijuar kapacitetet për administrimin efektiv të ndërmarrjeve të tyre në këto njësi administrative që vijnë si rezultat dhe i ndryshimeve administrative, që janë bërë dhe bashkimeve të reja administrative si rezultat i reformës të cilët kemi kaluar. Unë mendoj se ky komponent i parë është vazhdimi i një pune të nisur prej kohësh. Është komponenti i parë i fazës së tretë. Unë mendoj se duhet ta mbështesim, ta votojmë pasi është në përputhje dhe me Kushtetutën dhe projektligji ka respektuar të gjitha kërkesat e Rregullores.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi - Faleminderit!

Ka pyetje? Po.

Anila Agalliu - Faleminderit!

Zoti Gjika, në fakt ishte paksa i shkurtër në mënyrën e sqarimit të këtij projektligji, por gjithsesi duke qenë se jam deputete e qarkut të Beratit dua të di nëse ju si drejtori keni monitoruar në lidhje me ato investimet e infrastrukturës bashkiake 1 dhe 2? A keni bërë ju një kontroll, një monitorim, një raport të asaj çfarë është bërë në bashkinë Berat?

Dua të di se, përderisa këto shoqëri përfitojnë grante dhe kredi, që janë të buta, pse u drejtohen bankave të nivelit të dytë, ku duhet të marrin me interesa më të larta dhe ta shlyejnë kredinë për një periudhë më të shkurtër.

Faleminderit!

Po, zoti Gjika.

Jovan Gjika - Faza 1 dhe 2 aktualisht në Berat është në zbatim. Deri më sot kemi pothuajse të përfunduar gjysmën e investimit të parashikuar. Patjetër që ka monitorim, sepse ka supervizor, që është ndërkombëtar dhe patjetër që ka monitorime nga ne, nga drejtoria monitorime të vazhdueshme dhe nga ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve që është punëdhënësi i punimeve.

Lidhur me marrjen e kredive në bankat e nivelit të dytë kjo këtu është grant. Nuk e di çfarë konkretisht, por unë mbuloj pjesën e projekteve me KfW-në, që në kuadër të programeve financojmë pjesërisht grant, pjesërisht kredi të buta nga KfW-ja. Për fazën 2 përqindja e kredisë është 1,8%. Se si ndahet kredia ose grant pjesa, ka një model cash flow të përgatitur nga KfW-ja, që analizon me detaje aktivitetin e ndërmarrjes dhe me projeksion deri për 25 vjetët e ardhshme. Kështu që në bazë të asaj ndahet dhe porcioni, sa kredi mund të marrë në total, sa investime, sa financime dhe cila mund të jetë pjesa e ndarjes grant apo kredi.

Anila Agalliu – Kjo shoqëri i është drejtuar një banke të nivelit të dytë dhe ka marrë një kredi dhe tashmë është duke e shlyer, prandaj dua të dinë se këto shoqëri a përfitojnë kredi, grante dhe përsëri ato u drejtohen bankave të nivelit të dytë. Cila është arsyeja?

Jovan Gjika – Shoqëria e ujësjellës-kanalizimeve ka drejtuesit e vet, ata e dinë, nuk e dimë ne se për çfarë e kanë. Të paktën unë nuk kam dijeni se për çfarë kredish të bankave të nivelit të dytë bëhet fjalë.

Anila Agalliu – Meqenëse ju keni bërë monitorime, a keni ndonjë raport konkret që të na e vini në dispozicion?

Jovan Gjika – Nga konsulenti ndërkombëtar, që është supervizori i punimeve, bëhen raporte mujore dhe 3-mujore lidhur me ecurinë e investimeve.

Oerd Bylykbashi – A mund të na e vini në dispozicion deputetëve meqë e kërkojnë?

Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te votimi nën për nën.

Kush është dakord me nënin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nënin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te votimi në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet dhe në tërësi nga komisioni ky projektligj.

Më këtë pikë ezaurohet dhe çështja e fundit e rendit të ditës për sot.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET